

BIBLIOTEKA

884-1
D 73

Fatos
Arapı

Më vjen
keq
për Jagon

- Poezi -

Fatos Arapi

albin

891.533-1

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30
31
32
33
34
35
36
37
38
39
40
41
42
43
44
45
46
47
48
49
50
51
52
53
54
55
56
57
58
59
60
61
62
63
64
65
66
67
68
69
70
71
72
73
74
75
76
77
78
79
80
81
82
83
84
85
86
87
88
89
90
91
92
93
94
95
96
97
98
99
100
101
102
103
104
105
106
107
108
109
110
111
112
113
114
115
116
117
118
119
120
121
122
123
124
125
126
127
128
129
130
131
132
133
134
135
136
137
138
139
140
141
142
143
144
145
146
147
148
149
150
151
152
153
154
155
156
157
158
159
160
161
162
163
164
165
166
167
168
169
170
171
172
173
174
175
176
177
178
179
180
181
182
183
184
185
186
187
188
189
190
191
192
193
194
195
196
197
198
199
200
201
202
203
204
205
206
207
208
209
210
211
212
213
214
215
216
217
218
219
220
221
222
223
224
225
226
227
228
229
230
231
232
233
234
235
236
237
238
239
240
241
242
243
244
245
246
247
248
249
250
251
252
253
254
255
256
257
258
259
250
251
252
253
254
255
256
257
258
259
260
261
262
263
264
265
266
267
268
269
270
271
272
273
274
275
276
277
278
279
280
281
282
283
284
285
286
287
288
289
280
281
282
283
284
285
286
287
288
289
290
291
292
293
294
295
296
297
298
299
290
291
292
293
294
295
296
297
298
299
300
301
302
303
304
305
306
307
308
309
310
311
312
313
314
315
316
317
318
319
320
321
322
323
324
325
326
327
328
329
330
331
332
333
334
335
336
337
338
339
330
331
332
333
334
335
336
337
338
339
340
341
342
343
344
345
346
347
348
349
350
351
352
353
354
355
356
357
358
359
360
361
362
363
364
365
366
367
368
369
370
371
372
373
374
375
376
377
378
379
380
381
382
383
384
385
386
387
388
389
390
391
392
393
394
395
396
397
398
399
390
391
392
393
394
395
396
397
398
399
400
401
402
403
404
405
406
407
408
409
410
411
412
413
414
415
416
417
418
419
420
421
422
423
424
425
426
427
428
429
430
431
432
433
434
435
436
437
438
439
440
441
442
443
444
445
446
447
448
449
450
451
452
453
454
455
456
457
458
459
460
461
462
463
464
465
466
467
468
469
470
471
472
473
474
475
476
477
478
479
480
481
482
483
484
485
486
487
488
489
490
491
492
493
494
495
496
497
498
499
490
491
492
493
494
495
496
497
498
499
500
501
502
503
504
505
506
507
508
509
510
511
512
513
514
515
516
517
518
519
520
521
522
523
524
525
526
527
528
529
530
531
532
533
534
535
536
537
538
539
540
541
542
543
544
545
546
547
548
549
550
551
552
553
554
555
556
557
558
559
560
561
562
563
564
565
566
567
568
569
570
571
572
573
574
575
576
577
578
579
580
581
582
583
584
585
586
587
588
589
590
591
592
593
594
595
596
597
598
599
590
591
592
593
594
595
596
597
598
599
600
601
602
603
604
605
606
607
608
609
610
611
612
613
614
615
616
617
618
619
620
621
622
623
624
625
626
627
628
629
630
631
632
633
634
635
636
637
638
639
640
641
642
643
644
645
646
647
648
649
650
651
652
653
654
655
656
657
658
659
660
661
662
663
664
665
666
667
668
669
670
671
672
673
674
675
676
677
678
679
680
681
682
683
684
685
686
687
688
689
690
691
692
693
694
695
696
697
698
699
690
691
692
693
694
695
696
697
698
699
700
701
702
703
704
705
706
707
708
709
710
711
712
713
714
715
716
717
718
719
720
721
722
723
724
725
726
727
728
729
730
731
732
733
734
735
736
737
738
739
740
741
742
743
744
745
746
747
748
749
750
751
752
753
754
755
756
757
758
759
760
761
762
763
764
765
766
767
768
769
770
771
772
773
774
775
776
777
778
779
770
771
772
773
774
775
776
777
778
779
780
781
782
783
784
785
786
787
788
789
790
791
792
793
794
795
796
797
798
799
790
791
792
793
794
795
796
797
798
799
800
801
802
803
804
805
806
807
808
809
810
811
812
813
814
815
816
817
818
819
820
821
822
823
824
825
826
827
828
829
830
831
832
833
834
835
836
837
838
839
840
841
842
843
844
845
846
847
848
849
850
851
852
853
854
855
856
857
858
859
860
861
862
863
864
865
866
867
868
869
870
871
872
873
874
875
876
877
878
879
870
871
872
873
874
875
876
877
878
879
880
881
882
883
884
885
886
887
888
889
880
881
882
883
884
885
886
887
888
889
890
891
892
893
894
895
896
897
898
899
890
891
892
893
894
895
896
897
898
899
900
901
902
903
904
905
906
907
908
909
910
911
912
913
914
915
916
917
918
919
920
921
922
923
924
925
926
927
928
929
930
931
932
933
934
935
936
937
938
939
940
941
942
943
944
945
946
947
948
949
950
951
952
953
954
955
956
957
958
959
960
961
962
963
964
965
966
967
968
969
970
971
972
973
974
975
976
977
978
979
970
971
972
973
974
975
976
977
978
979
980
981
982
983
984
985
986
987
988
989
980
981
982
983
984
985
986
987
988
989
990
991
992
993
994
995
996
997
998
999
990
991
992
993
994
995
996
997
998
999
1000

854-1
A73

Fatos Arapi

ME VJEN KEQ PER JAGON

- poezi -

BIBLIOTEKA
BASKIS GJEROVASTER
NR INV *52896*

albin
1994

Më vjen keq për Jagon Fatos Arapi
Kopertina Azis Karalliu
Radhim kompjuter Teodora Naçko
Art grafik Blerina Bala
Botues **Albinform**

Më vjen keq për Jagon

*Më vjen keq për Jagon:
kaq shumë fyerje,
kaq shumë poshtërimë,
kaq shumë neveritje.*

*Në fund të fundit,
për një Desdemonë;
në fund të fundit,
për një arap Venediku.*

*Më vjen keq për Jagon:
në fund të fundit,
nga shkaku i një shamije
prej asgjëje.*

Një oqean përcmimi në sytë tuaj...

*Kur në bukën e përditshme vrasin Zotin,
me gjak perëndish vaditin themelet e tempujve të
tyre.*

Në sytë e njeriut loti ndjen tradhëti.

Liria juaj ndjen tradhëti prej vetëvetes.

Më vjen keq për Jagon.

1976

Oh, që paskemi të gjithë...

*Oh, që paskemi të gjithë
diçka prej Don Kishotit!
E shohim tek endet nëpër kurmin tonë
si një kokërr gruri
në tule të dheut.*

*I imtë.
I mirë.*

*Mbi Rosinantin tërë dregëza
u sulet mullinjve të erës:
e Sançon thërret,
e Dylqinës i përbetohet.*

*Nënqeshja e tij e pafajshme,
lulubeçkë prilli, bulëzon syve tanë.*

*Ai në kurmin tonë endet,
tragjik,
njerëzor,
e prandaj i madh.*

1969

Kur lozim me vveteten né, poetët...

*Kur lozim me vveteten né,
s'u ngajjmë berave
që kërcejnë prillit pranë nënave,
 deleve;
s'u shëmbëllejjmë valëve
që puthen midis shkumëve,
 të bardhave.*

*Kur lozim me vveteten né,
kur lozim né - poetët!
Se botës më s'i duhem,
pa s'ka kuptim t'i truhemi...*

*Dhe lozim me vveteten né...
Edhe u ngajjmë... Kujt? - Oh!
Po unë s'di më
të tjerë të lozin përmbi dhé
me tragedinë e tyre përgjithnjë,
si me vveteten lozim ne - poetët.*

1968

Më vjen keq për Jagon

Më vjen për të qeshur me tragjeditë

*Më vjen për të qeshur me tragjeditë:
zgavra të vjetra e të njoma fare.
Kalbur tutje nëpër lashtësitë,
na përshëndesin me dorë përpara.*

*Bërrthama legjendash janë prapë aty.
Paçka që ty s'të shkoka në mendje,
paçka që ti, ndofta, tani
vetë tragjedi e rëndomtë më qenke...*

*Në sy tragjeditë e mia kam parë:
dhe më vjen për të qeshur
dhe më vjen për të qarë.*

1972

Ku tē varros?

*Me ty nē duar, me ty nē duar,
e ftohtë, e vdekur, ku tē varros?
Dku nē mendje? - Ti s'ke pranuar.
Diku nē shpirt? - Dot s'tē gropos.*

*Shkoj nēpër tokë, shkel nēpër kohë,
dy gisht varr për ty dot s'i gjej.
Kthehem e hyj nē pikë tē lotit -
aty tē lëshoj, tē vendos... e tē preh.*

1972

Për gjithë dashuritë

*Për gjithë dashuritë jam unë këtu:
i tëri plagë e përsëri diell.
Shtypur e rrahu e ndohtur gërrdhu -
e përsëri nder.*

*Jo një feniks, milionë feniksë
tek unë shkrumbohen përditë...
Ju thoni lindja? Më e tmerrshme vdekja e tyre...*

*Për gjithë dashuritë
në vdekje fenikse këtu i mbërthyer.*

1972

Aspirinat

*Aspiriné në xhepin e vogël tē pantallonave.
Aspiriné në xhepin e xhaketës.
Aspiriné në xhepine e çantës.*

*Më dhemb koka mua.
Më dhemb koka mua.
Më dhemb koka mua.*

*Po tē isha unë perëndi-gomar,
perëndi-gomarët ç'do tē më bënин?
Po tē isha unë hero-gomar,
hero-gomarët ç'do tē më bënин?*

*Mua më dhemb koka dhe i fus aspirina.
Vdekjet janë aty me vjetë, me dhjetëra vjetë.
Ah, Marie e horrave, pse nuk ishte nëna ime?
Nëna ime, Shën-Mëri e vërtetë.*

*... si fëmijët ca karamele
aspirinat në xhep.*

Ah, Marie e horrave, pse nuk ishte nëna ime...

1976

Papagajt

Në degët e skeletit tim

ulen papgajt:

një papagall,

dy papagaj,

tre papagaj.

Disa papagaj.

Tufë papagajsh.

Gjithë pupla, tërë ngjyra.

Krekosen. Krekosen.

Me gisht loz me sqeþhet

përthyer...

R...

Rr...

Rro...

Rrof...

Rroft...

- Oh, papagaj!

U...

Ur...

Urr...

Urra...

Urrah...

- Ah, papagaj!

Fatos Arapi

L...
La...
Lav...
Lavd...
Lavdi...

- *Hi, papagaj!*

Papagajt flasin.
Papagajt krekozen.
Papagajt kuisin.

Unë u them: - Rrini, more, papagaj.
Ç'keni, more, papagaj?
Ç'ju duhet juve, more
papagaj.

Nga dolën këtu tek unë, si erdhën?
Eh, pra, nuk jam as Amazona, as Afrika e nxeh të.
Si çelën kështu në këtë Shqipërizezë,
të më plasin shpirtin, të më nxijnë jetën...

- *A dini ç'ka, papagaj? A s'e mbyllni sqepin...*

1976

Më vjen keq për Jagon

Lindja e dashurisë

po qajnë gjithë Xhuljetat, zinule, ringj, e te' u dësu.
po qajnë Ofelitë. zinule
Një dashuri tjetër c.
Lindi këtë ditë. B.

Atje ku lidhet qielli, 1
e qiellore në shpirt, 2
në botë ajo erdhi c.
Si ardhkën dashuritë. B.

Brerimë jetësh gjëzimi / orari/
pikëlojnë nér qerpikë:
ato janë Xhuljetat,
ato janë Ofelitë. / orari/
Ato që janë dhe natë, / orari/
ato që janë dhe ditë. / orari/

Pa to ç'do ishtejeta,
vdekja ç'do tē qe? *puyoh-e retori*
Një motërz e vogël *o/ruite*.
u erdhi sot mbi dhë.

Pa qajnë mbi tē Xhuljetat,
pa qajnë Ofelitë:
do ketë fatin e tyre
dhe, ndofta, më tragjik.

1976

Më vjen keq për Jagon

Me arkivolin tim mbi kuriz eci...

*Me arkivolin tim mbi krriz
kaloj udhës së heshtur.*

*Asnjë kortezh.
Asnjë funeral.*

*Jeta nuk qenka stacion dashurish:
- Lamtumirë! Udhë e mbarë...*

Me arkivolin tim mbi kurriz

eci...

*Nuk mbart poetin,
as këngët Hamlet,
që nga tragjedia në tragjedi
kërkojnë Hamletin.*

*Po shpie njeriun që i rastisi
me nofulla të kyçura të dëgjojë
zërin e vet kur thëriste:*

*- Njerëz, të mundnja
vet Akerontin do ta ktheja nga udha!
T'u kërkoja, t'u gjeja ku ishit...
Njerëz të mi, liri të mia !
Ja, ku jam përsëri...*

*Ja, vdekja ime...
Merreni, se ndofta, dikur do t'ju duhet...*

*Ah, të mundnja,
gjithë Akerontët do t'i ktheja nga udha!*

*Unë që me arkivolin tim mbi kurriz
eci...*

1980

Nuk e di ç'kohë qé...

Nuk e di ç'kohë qé, nuk e di cili shekull.

P-F

Ish një kthinë e vogël, dhe një terr i verbër.

Një frikë e ankth, dhe një turp çnjerëzor.

Gjer në palcë e fyer dashuria jonë.

N'errësirë rrëmbenim ne njëri-tjetrin.

Frymëmarrjen përgjysëm, lotët përgjysëm.

Gjithë shpirtin e saj unë pinja i etur

dhe prap s'kishte të ngopur trup'i ethshëm, i drithshëm.

Dashuri nëse ka, çmenduri në ka bota, -

çmendurisht dashuronim ne të dy njëri-tjetrin.

Ndofta ishte Evropa... Pse të ishte Evropa?!

Ndofta shek XX... Pse të ishi i XX-ti?!

1980


Edhe pa Fatosin
në kryqin e skeletit të Fatosit

kryqëzova gjithë padrejtësitë e botës.

Edhe pa Fatosin

Në kryqin e skeletit të Fatosit
kryqëzova gjithë padrejtësitë e botës.

*Liria ime! Më mjafton ti,
edhe pa Fatosin.*



Ti mos më ler vetëm

*Unë jam parë sy-më-sy me jetën,
unë jam ngrënë dhemb-më-dhemb me vdekjen.
Dhe jeta dhe vdekja ishin të egra -
ti mos më lër vetëm.*

*Tiranët më njohën, në firomë u prenë.
Më ndjenë që vija, në zemër u zbehnë.
E di: me ta do përleshen prapë nesër -
ti mos më ler vetëm.*

*Liria ime është si jam vetë.
I vdekur? - U ngrita: Sërisht më thërrasin...
Prej meje kërkojnë dhe jetën dhe vdekjen -
ti mos më lër vetëm.*

1980

Në kaq pak Tiranë

D.

*Në kaq pak Tiranë,
si mund të mbetesh kujtim,
si mund të kthehesë në mall.*

*Dhimbja e natës,
natën e zgjon. -
Si mund të bëhes tragjedi...*

Në kaq pak Tiranë.

1981

Vargje gushti

*Ti u nise plazheve brunë,
anëdetesh të bardhë u nise.
Një poet i varfër si unë,
s'të ndjek dot ndër filladitje...*

*Ti u bëre trishtim që thërmohet
në mallin muzgor të një dite.
Ikje e lehtë anëdetesh u bëre.*

*Unë nën shuarje të diellit të gushtit,
nëpër gjurmë e këmbë të tua,-
përpëlitje e një shpirti prej rëre?*

1981

Në fund të fundit Troja kishte rënë

D.

*Unë e dija: në fund të fundit Troja kishte rënë.
Duhej të vdisnin - kishin vdekur Hektori dhe Akili.
Hekuba ç'mund të ish më shumë se nënë?
Më shumë se tragjedi mbrunte kujtimi e hiri.*

*Helenat kthejnë gjithnjë tek Menelatë. Unë e dija...
Dhe prap veten e ngrita në rrënojë:
gjersa ka një Helenë, duhet të ketë një Trojë.*

Kasandër, motr'e zemrës, kur fillon tragjedia?

1972

Ubi Heroës?

*Eshtë nata e varrit ajo që përsipër kalon
me lulet e zeza të vdekjeve tona në duar.*

*Ku janë herojt?
Më të lirë se Liria.
Më éndërronjës se Endrrat.*

*Ubi heroës?
Nga dora e Drejtësisë
Ka rënë shpata, - në dorë të tiranit
tani djersin gjakun tonë.*

*Cili burrë do të vi të ndezë
kandilat e shuar të zemrave.
Dritave t'u mësojë të jenë më drita.*

Ku janë herojt?

Oh, që ishim të mirë ne...

*Oh, që ishim të nirë ne-
heroikët,
ne - tragjikët.*

*Oh, që ishim të mirë ne-
që pimë gjak me liritë.
Trupin e njëri-tjetrit premë,
gjak pimë me Dashuritë.*

*Ne - heroikët...
Paralele e meridianë
i kthyem në fije brinjësh:
brenda tyre të rrahë
zemra - pazemër - e botës.*

*Ne - tragjikët...
E dinim që mbanim
Shpresën - pashpresë - në buzë
si një kokërr meli rabecka
nëpër furtunë.*

Oh, që ishim të mirë ne...

1968

Kur ndaheshim ne...

*...ahere pash natën në sy,
ndarjen, juve të gjithëve.*

*Tej digjej Perseu,¹
shkrumbohej tutje Andromeda.
Në zjarre të tyre dorën e krođha.*

*Dashuri e shek.XX,
edhe ti paske nevojë për Mucis Scevola?²*

1/Perseu, Andromeda - grup yjesh, Ylliësi

*2/Mucius Scevola - romak, i cili sipas legjendës krođhi dorën
në zjarr për tu betuar se nuk gënjenie.*

Në 40 vjetorin tim

*Në 40 vjetorin e datëlindjes sime,
40 qirinj s'i ngula
në tortën festive.*

*Në 40 vjetorin e ditëlindjes sime,
40 pikëpyetje në tru
i ndeza qirinj.*

1970

Vargje spitali

*Ku po më çojnë dallgët e dhimbjeve?
Te këmbët e mia Butrinti,
me perënditë e thyera, të humbura.
Ashtu le të ngjallen dhe kockat e mia?*

*Njerëzit statuja nuk janë.
Njerëzit si statujat s'e kanë.*

*Fryjnë e shfryjnë dallgët e dhembjeve.
Dhe unë me çarçaf mbuluar,
në jod e gjak, përmes harrimit,
loz e mbaj nëpër duar,
kryet e perëndeshës së Butrintit.*

1970

Ju shkonit për ku?

*Ata do t'ju thonë që unë i urreja
për zonjat e ajthme, të thekura plazheve brune.
unë isha burrë... më pëlqente
të lëpija diellin në lëkurën erëmirë të tyre.*

*Do t'ju thonë që dot s'i duroja
kur mbanin në xhepe, si kokrra arrash,
Romën, Parisin, Athinën.
Dhe mua argatit të fateve shqiptare
më jepnin Zvérnecin, Oroshin, Smokthinën.*

*Ata do t'ju thonë... por, ju mos besoni-
prej tyre më ndanit veç ju:
ju vinit për nga?
ju shkonit për ku?*

*Kur ju ishit Humbja, unë ç'duhej të ishja?
Prej shkretëtirës së syve të tyre
më kanoseshin sfinksët.*

1976

Më vjen keq për Jagon

D.

*Të tjerët le të mos e dinë, ti dije:
si drejt dritës kthehet përherë një lule,
çdo i vdekur si unë
ndjek një diell si ty -
mbi krye.*

1976

N'udhëkryq të jetës pres...

*N'udhëkryq të jetës
jam ngulur e pres.*

Kryqi i drujtë kalbet dikur.

Kryqi im është i përjetshëm.

1976

Bëjeni për mua...

*... si titanë, çmendurisht dashurojini
dashuritë tuaja - si unë Atë...*

*Sazani, Zvërneci dhe Malet e Vetëtimave -
Si pulëbardhat në fluturimin e tyre,
thyejnë krahët brenda emrit të saj.*

*Jam i vdekur, besomëni.
Dhe tani ju flas nga përtej varri: si titanë
çmendurisht dashurojini
dashuritë tuaja.*

Bëjeni për mua këtë.

1976

Ah, liri...

Ah, liri...

*Përse këto eshtra të tuat
më qenkan bërë prej ngashërimesh,-
kush i dëgjoi një herë
s'i harron dot më kurrë.*

*Përse, e dashura ime,
paske nevojë për gjak nga gjithë tokë,
nga gjithë popujt, nga gjithë kohët...
Dy gisht nën cipën tënde gërvishët
dhe trageditë e tua takoj...*

*Të tuat,
apo të miat?*

1980

Më vjen keq për Jagon

X

X

X

*Shpirti i dashurisë
s'braktis dot kryqin e vet.*

1981

I ndershëm si vdekja

*... para meje poshtërsitë
si terri para dritës.*

*Skllevër-bij-skllevërish shqyejnë
ditë e natë, me dhëmbë të ndohtë,
zemrën e Shpresës sime.*

E unë i ndershëm si vdekja.

1981

... tepër modern unë

*... tepër modern unë
për muzetë tuaj... Armaturat e ndryshkura
mesjetare.*

... tepër modern unë.

*Tragjedia është Atdheu i vërtetë i poetëve,
dhe unë prej kohe kam hyrë
në tragjeditë e ardhme të lirive.*

Far i ndezur para se të vijë nata.

1981

Anës Vjosës

*Moj kokë e qenit, moj qene,
s'mendove për veten tënde,
prej bodrumit s'i s'u trembe.*

Popullore

*Tek po shkoja anës Vjosës,
buzë mbrëmjes i menduar,
një si krisje egër kokës,
dielli vet mu errësua, -
mu në tuç të kokës sime
sikur ra varrë e kohës.*

Ç'dreqin thashë, kështu me mua...

*Koka një breshkor'e hekurt
më tërhiqte gjithnjë poshtë:
atje dhimbjet, pshëritimata,
atje fatet-emrat tuaj,
si milingona të dheut.*

*Koka një bunker çeliku,
tonelata peshë mbi supe.
Dita shkel mbi shpirtra njerëzish,
kurse ti, një zokth i qiellit,
poezinë tënde kërkon.*

Shtetet - brenda e jashtë hekur
(mbeti një vegim Mesjeta);
klasat - dema që ndjejnë gjakun -
dhe, shiko! - Ti je arena
ku përleshet jetë-vdekja.

Ç'dreqin, thashë, kështu me mua...

Ç'dreqin, thashë, me këtë kokë!
Pse u dashka gjithnjë unë
të jem gozhda ku u varkan
gjithë tragjeditë e shekullit?
Të përleshen me xhelatët
edhe përtej vdekjes sime...

Zot, të isha bukurezë!
Të jetoja vec një natë,-
vec një natë shpirt-maji...
Pse u dashka gjithnjë unë
i pari ta çajë dëborën?

Zot, të isha lodër qelli!
Fluturim i një buzëqeshje
në buzë tuaj të isha.
Unë të isha dega e vetme
ku më ulet zok i gjumit.

Çfarë dashnori isha unë,
e di vetëm dashuria.
Ndanë brigjeve të Tunës,
ajo qanë e qanë për mua.
E ka marrë kryet në duar,
pa me grushte ma rreh globin.

Ç'dreqin, thashë, me këtë kokë
që më jep urdhra të tillë:
- Ty, të ndalohet të vdesësh,
s'të lejohet që të çmendesh,
duhet vetëm të qëndrosh...

Jo ti - vdekja jote ecën,
si një qen që mban në gojë
këmbën e tij të coptuar.
Digju si kandil i qiellit,
edhe kur ka shkrepur drita.

Ç'dreqin, thashë, dhe kokën kapa,
e çvidhosa mirë-e-mirë,
e rrëmbeva me dy duar
dhe e flaka përmes valëve,-
valëve që sillte lumi...

Rrokullisej si bucelë,
si bucelë që shkon nën ujë.

Më vjen keq pér Jagon

*Unë - një horizont i lehtë.
Shpirt i vetë lehtësisë.
Shkelja kund pa vënë këmbën.
Unë ecja zemrës qìllit,
s'kisha më nevojë pér tokën.*

*Doni ju? - Unë jam çlodhja.
Doni ju? - Unë jam paqa.
Doni ju? - Unë shfletoj
si një nxënës katershoret,
fletët e holla të qìllit.*

*Unë harrova si në darkë,
në tryezë të bukës uleni,-
flisni ju me veten tuaj...
E dëgjoja - dikush fliste,
po gjuhën tuaj harrova.*

*Dhe aher'i shkela synë
zbrasësisë të kohës sime;
unë i nxora gjuhën shekullit,
brylin i tregova - na!
Tani jemi fit-e-fit!*

*Tani jeni ju pa mua...
Pa të shohim ç'zgavër hapet
mespërmes frymëmarrjes suaj...
T'u shikoj se si vërtiteni,
si një sy që humbet dritën.*

*Koka ime tani nxinte
si një gogël qiparizi,
valëve që shtynte lumi.
Dhe më zhdukej gjithnjë syve,
dhe humbiste atje tutje.*

*Atje tutje hapej deti
që thëthinte Vjosën vetë.
Oh! Dhe dallgëve u lëshova,
duke mbajtur nër dhëmbë shpirtin,
unë e kapa kokën time.*

*Kokën që s'doja ta humbja,
e vidhosa mirë-e-mirë,
përmbi supet themeli.
Më kishte shërbyer e gjora,
s'më kish tradhëtuar kurrë.*

*Sa herë unë e përplasa
shkëmbenjve - ditëve të mia -
qoftë dhe një zemrek i vetëm
nuk u thyen brenda saj.*

*Anës Vjosës tek po shkoja,
buzëmbrëmjes i menduar,
nisa prapë të këndoja:
"Moj kokë e qenit, moj qene,
S'mendove për veten tënde..."*

1976

**Duke shkelur mbi gjelbërimin
e ditëve**

poemë

I.

*Duke shkelur mbi gjelbërimin e dendur
të ditëve,
mbi gjethe e fletëza të fjalëve ende të pathëna,
nëpër qilim të trashë të lavdive poetike,
dola jashtë Fatosit,
përshëndeta botën:- oqean emrash, fytyrash,
vargan dallgë dashurish,
që ngrihen prej diku,
që shkojnë për diku...*

Përshëndeta botën... dhe ju.

*Pastaj u ktheva,
pashë Fatosin poshtë - i thirra:*

Tungjatjeta, Fatos.

II.

Ja, cili më qenke ti...

Ballin mbështetur te kupolë e qelqtë qiellore.

Sheh rruzullin - anije kozmike

ngarkuar me pasagjerë.

Çdo njeri nër duar mban ëndrrat e shpresat,

lindjet e vdekjet e dashurive të veta

pasagjere.

Ja, cili më qenke ti...

Nofullat e gjera bluajnë tragjeditë

e përditshme të jetës.

Ciflat e tyre të mbetkan nër dhëmbë,

dhëmballë.

Ja, sytë e tu...

Duke u përkulur mbi brigjet buçitëse të tyre,

nëpër thellësira të dritave marramendëse

të shekullit,-

ré

dhe mbete atje,-

ti vetë një narciz i bardhë.

III.

Tungjatjeta, Fatos.

Më fjetë me Mesjetën te koka

dhe nuk e dite.

Nëpër gjakun tënd gjysmëhëna ende përgjoka
dhe ti nuk e di?

Dhe prapë
mbi dy ikset e shek.XX.
u shtrive gjerë e gjatë.

Ata që mbi shpatullat e tyre ngritën ato ikse,
hamenj fitoresh e gëzimesh, funeralesh të kohëve,
në mesin e udhës psherëtitën:
qenka i rëndë!

Ti, edhe i vdekur, murmurite:
nuk isha i dobët,
shekulli im, ndofta, ishte ende i pafuqishëm.

IV.

Pse tund kokën me vete?
C'bisedon me vetvete?

Uli fletzat e buzëve...
Fryji dhe mvishë globin me frymë.

Tani,
mbi çeturin e dheut, ç'do të shkruash?

*Nëpër afshe shpirtrash të kohëve
ti me gisht shkrove:*

“Unë”?

Po më dhimbshesh, Fatos.

V.

*Mund t'u marrësh erë qiejve
duke mbajtur në dorë
një narciz
të këputur mes diejve.*

*Dhe n'Harushën e madhe,
në karrocën prej yjesht,
ëndrrat-kuaj i mbreh...
Nëpër fusha eterne tani të shëtitësh.*

*Prej ëndrrash eterne dashurinë të krijosh.-
Endërronjësi, Fatos.*

V.

Dashuria sijeta ushqehet me veten e vet...

*Ajo do të hyjë mes mendimeve të tua,
si një anije e bardhë
do lundrojë tek ti me vjet e vjet.*

Dashuria, sijeta, ushqehet me veten e vet.

Më vjen keq pér Jagon

VII.

*Po kur, - sa hap e mbyll sytë -
ti vetë u ktheve në kujtim të saj?*

*Tani më shëmbëllen me një libër
të palexuar,
që çuditërisht e ditkam përmendsh.*

*Fytyra e saj po shkrihet tek ty
dhe tretet ajo me të tjerat.*

*Cdo pikëz e shpirtit tënd
arenë e re dhe antike qenka.
Dashuritë gladiatore
në dyluftime ndeshen aty?*

Ç'po më thua, Fatos!
Ti asaj i thërrret: Eja, e bukur!
Eja, e ëndërruar!
Eja... Unë drejt teje po vij.
*Cili prej nesh më fort po rend
t'i dalë përpara njëri-tjetrit?*

Ti?

Unë?

*Cili prej nesh më parë po rend
të pushtojë njëri-tjetrin?*

*Fytyra e saj shkrihet...
Ti në veten tënde atë e gdhend,
si në kolonat e hershme kapitalet gdhendnin.*

VIII.

Tungjatjeta, Fatos.

*Ç'është kjo fjalë, që papritur qëndroi
midis buzëve të tua?*

*Brenda saj,
si brenda lentes së një teleskopi,
galaktikët hyjnë, lëvizin.*

*Brenda një fjale të vetme
jetojnë galaktikat:*

Nefertitja...

*Diku nëpër hapësirat e pafundme të qenies sate;
diku nëpër horizontet pa mbarim
të këngës sate.*

E vogël. Nefertitja...

*Farë e çuditshme
hedhur nëpër brazdat e ngrohta*

të pranverave të shpirtit tënd.

*Mbijnë prej saj gjelbërime të panjohura,
rrezëllime të dridhshme, të dridhshme.*

*Dhe ti atë me vete e mban,
jo si i krishterit një ashkël të kryqit të Krishtit,-
ti atë me vete e mban,
si cifël sharapneli
ngulur diku në trup të luftëtarit.*

IX.

*Përse kërcet dhëmbët, nofullat?
Mbyll sytë prej dhimbjes së egër.*

*Brenda këtij çasti, si në qivurin e vet
pranvera, - u shtri Dashuria?
Ky çast në trupin tënd mbeti
qelizë e ngrirë, e vdekur?*

*Varr dashurie është çdo grimcëza jote?
Oh, Nerftitja...
Gllomçë e një fjongoje, që lidh
hapësirat e tua.*

*E vogël. E brishtë.
Tek ti qëndroi, si krahu i bardhë i një fluture
mbi fletëz të ditës së majit.*

X.

*Tungjatjeta, Fatos.
Duke gjykuar kohërat e shkuara,
hynë vetë në gjykimin e tyre.*

*Në mesin e udhës së jetës sate
ti ndale i heshtur, Fatos.
Ç'shi i dendur gjykimesh po derdhet
mbi ty!*

Shi.

Shi.

Shi.

Gjykojnë ditët e netët,

muzgjet, agimet.

Shi.

Shi.

Shi.

Gjykojnë vjetët, dekadat,

njerëzit, gjeneratat.

Cili je ti?

Prej ç'përbërje janë gatuar këto stina të tuat?

Si qenka deformuar kështu

kjo mëngë e shpirtit tënd?

Ti me zëra përreth murmurin: - Nuk ishte lehtë.

Shekulli ishte i rëndë.

Nën peshë të tij

dhe shpirti diku varej,-

si varet barku i nënës

nga barra e pjellës së vet.

XI.

Nuk është lehtë.

*Tani thellë teje kredh duart e mia
dhe nxjerr prej andej gjithshka tënden:
ditë të përgjakura e ditë të kaltëra;
biseda me erërat e qiellit
që kthehen në fjalë lirie;
betime mbi kokrrën e grurit
 mbi kokrrën e djersës;
dashuri njerëzore,
kujeta përgjon, si brenda një kokrre gruri,
si brenda një pike drite.*

*Thellë teje mbush duart e mia
dhe hedh nëpër ajë: pranvera
 që u betohen pranverave.
Endrra, që vetëm ëndrrave u betohen.
Dhe i thonë njëra-tjetrës:
shëmbëllekemi me statujat,
që ndofta më të bukura zgjohen
 nga gjyntimi i kohërave.*

XII.

Pranë njëri-tjetrit flasim në heshtje.

*Në cepin e buzës tënde u ul një buzëqeshje?
E di çdo të më thuash:*

*Rruzulli... Shih sa shpejt e ndrroka
lëkurën e vet laramane.*

*Mjaftokan 5 a 10 vjet...
Dhe lëkura e rrizuillit rënka trokë
e lindka tjetra.*

*(Dhe breshka, kur rritet
breshkoren e lënka diku?).*

*Ku e lë rrizuilli lëvozhgën e vet?
E reja që lindka ç'na fsheh atje poshtë?*

XIII.

Tungjatjeta, Fatos.

*Kam parë gëzimin e vdekjes e të lindjes
të planetëve të tërë, nëpër trupin tënd.*

*Dhe ty të kam parë shtritur,
që nga trajektorja kozmike
e gjer te gjurma e parë e njeriut
që duke u lëkundur, qëndroi mbi tokë,
më këmbë.*

*Rruzulli...
Nën lëkurë prej grataçielash të bardha,
nën farfuriqë të lëmuar të dritave,
ç'na fsheh atje poshtë?*

*Ti, dy gisht lëkurën e njomë ja ngrite,
dhe përnjëherësh sytë
me pëllëmbët e tua i mbylle.*

XIV.

*Ejani, hapësira të mia.
Ejani; afrohuni.
Merrni cilëndo fytyrë që të dëshëroni.
Vetëm ejani...
Qiej, që s'ju kam ëndërruar...
Unë vetë po eci nëpër veten time;
shkul kufijt e qiellit
si shkulim hunjt nga gardhi i arës
të varfër, të vogël.
Ejani hapësira të mia.
Me mijëra e mijëra fytyra të dashuruara
ju marr në sy...
Ju përqafoheni,
njëra-tjetërën përkëdhelni brenda syve të mi.
Dhe unë po ju çoj nga një ditë te tjetra,
nga një këngë te tjetra.*

XV.

*Tungjatjeta, Fatos.
Dikush po çukit tek ti këto ditë,
si zogu nëpër kokrra meli çukit.

Në buzët tonë ky çast
s'ka për të çelur më, si një lulebeçkë.
As ti do të mbështetesh mbi kujtimin tënd,
as ke për të ndjerë fijet e brinjëve të ëndrrave
të prekin, të shtypin ijët e tua.*

Kujtimet bien prej nesh si gjethe të thata?

Profkal! Kujtimet si gjethet nuk bien,

as zgjohen ato nëpër gjurmët tonë,

as shkelim dot përmbi'to,

deshë të them.

Dikush po çukit tek ti këto ditë...

Vijnë të tjerë:

nër sytë e tyre plot dritë,

mbajnë të drejtën

dhe ata të krijojnë kujtimet e veta.

Që ne të ikim këndeja

e drejta e tyre na qenka.

Ti duhet këtë ta kuptosh...

Tungjatjeta, Fatos!

1970-1972

Më jepni një emër...

*Lindim dhe emra na veshin në trup.
Në lëvozhgë emri dikush na fut.
Skaliten pastaj në mermerin e bardhë,
në bust të gurtë:
p.sh. Qezar,
p.sh. Brut.*

Më jepni një emër...

*Të largët...të largët...Pastaj një të afërt.
Binjakë siamezë emrat të jenë.
Nuk ju kujtohen?
Po thoni Krujë
dhe dëgjo - Kartagjenë.*

*Emrat lindin, rriten e vdesin.
Dhe dashurohen emrat si njerzit.
Dhe nga dashuria lëkurën emri-
emrit ia shpon.
Thërrite Othello?
Përgjigjet: Desdemon.*

Më jepni një emër...

Më jepni një emër...

*Ku unë të jem tek ju,
sijeta në pikën e gjakut;
ku ju të ecni mbi mua,
siç ecni në rrugë.*

*Nëpërmjet këtij vitesh
dhe luftërat dëshiron
dhe plagët dëshiron.*

Më jepni një emër...

*Ku brenda një bulëze loti
të fluturoj si Ikari.*

1971

Përpara gjer në humbëtirë

*Zot i mirë! Lajmëro botën: këndeja
sapo kaloi shoku Don Kishoti*

I.

1. *Shaluar èndrrës Rosinant
kalëron Don Kishoti.
Në muzg gomari i Sanços pas
më i mençëm se i zoti.*

*Sheh të sojlliut kokëbrok
tek thyen horizontet,
dhe ngre gomari shalëplot
përplas rruzullin-tope.*

2. *Gëryen altret e vjetër
syri i tij i verbër.
Në buzë akrepe vdesë vet vdekja
në një shaka të egër.*

*Ai zuzar në rrokopujë
dhe shpresë e vegjëlisë;
kryeçlironjës në rrëmujë
dhe xhelat i lirisë.*

3. *Në natë të sotme proçkë e vjetër
në ditë të djeshme klloun i ri.
Kokalla Rosinant po ecën,
shkel e thundron shpirtin-njeri.*

*Kërkëllin tërë karkasë e krimit,
Saturn-liria ha bijtë e vet;
një fije zëri natës dimrit
“Ndihmë!” këlthet viktimë-jeta.*

4. *Përpara gjer në humbëtirë,
ku s’mbretëron asgjë!
Mba frymën Rosinant i mirë
dhe Sanço shoku gdhë.*

*Kur të mëdhenjt nisen prej zeros
bëjnë një gabim fatal:
se brënda zeros ka prap zero,
e zero brenda saj.*

5. *Përpara, përtej zeros fare,
se zero jemi vet!
Brënda gomarit është gomari
e tjetër s’mund të ketë.*

*- Imzoti-shok, me një barrë mënd,
gjetkë hidhmi ato vickla!
Lopa e pjellë viçin mënd,
kërricin gomarica...*

6. *Atje ku fushë e trurit heshtet
dhe zhdukët shija e motit,
po ngrihet kryq i zi i Njëshit,
fatalit Don Kishotit.*

*Kuptimi i tij katersh pret qielin,
horizontin e ndohtë.-
Dhe ti, dhe unë, dhe të gjithë jemi
në 1-shin Don Kishot.*

7. *Ai si krimbi në një mshikës
përbrënda fjalës “Ne”,
kalëron trokthi Historisë
si në një pëllëmbë dhé.*

*Përpara, gjer në humbëtirë,
se humbje jemi vet!
Përbrënda krimit është veç krimi,
e tjetër s'mund të jetë.*

8. *Gërryen hijeroret e vjetra
vështrimi i tij i verbër;
në buzë akrepi vdes vetë vdekja
në një shaka të egër.*

*Dhe bje më gjunjë Ai i madhi
përpara fjalës “Ne”,-
te rrëzë e saj, si te altari,
përkulur gjer më dhé.*

9. "Ne"-ja miliona thnegla dheu
duan dhe punë dhe bukë.
*E pafuqishme që kur leu,
që kur leu pa duk.*

"Ne"-ja pa ngjyrë e pa' formë,
"Ne"-ja, amebë e gjallë.
Me gisht tregonjës tani shkruaj:
"Ne-hicasgjë... ", në ajër.

10. Ç'kanë bërë kështu me ty, vëlla,
prej teje ç'kanë sajuar:
*kjo dora jote kanxhë hata,
plënci daulle e shpuar.*

*Calik lëkura jote e trashë,
syrin e merr të qarët;
me kafkën tënde kupë e zbrazët,
dolli ngrenë barbarët.*

11. Ç'kanë bërë kështu me ty, vëlla,
prej teje ç'kanë sajuar:
*natë e ankthit tënd hata,
zemra hënë e dhunuar.*

*Hidh gaz'e helme, aty hidh,
përzierje vrerësh, lëngrash.
Ti, fli e mjerë dashurish,
në hekatombe ëndrrash.*

12. *O agim Sanço! O mëngjes Sanço!
O liri Sanço! robëri Sanço!
O drejtësi e drejtësive Sanço!*

*E sotme Sanço! E nesërme Sanço!
O e vërtetë e gjithë të vërtetave!
O ti, m'i madhi i gjithë vogëlucëve, Sanço!*

13. *Në mur të dashurisë njerëzore
të dy kokën përplasin:
- O Zot, që veten e mohove,
dhe zot na dhe, thërrasin.*

*Ç'qe kjo mëshirë e pamëshirtë,
ky gaz'e vrerë pa fund,
të pjellë kështu mëngjesi i dlirtë
njerithin-perënduc.*

14. *Në mur të marrëzisë njerëzore
të dy kokën përplasin:
- O Zot, kur veten e mohove,
pse zot na dhe, thërrasin.*

*Pëlçet në sytë e Don Kishotit
një sumbull e përflakur,
dhe Sançua me pëllëmbë të dorës
pi gjak e lotë gjaku.*

15. *Rrumbull në sy të Don Kishotit,
loti veson vesë:
po qanë dhembshuria e Botës,
shpirt i Botës dëneset.*

- *Imzot, prej qerpikëve tribunë,
loti përposht merr sheshet.
Për nder! Diku përbrenda Sançoja,
mbi vet Sançon ngërdheshet.*

16. *O varfëri e varfër Sanço!
Mjerim i mjerë, o Sanço!
Dramë e dramave, skenë e skenave,
sofër e sofrave, o Sanço!*
17. *Gomari i mençëm e i urtë
shkon pas, i merr erë tokës.
Dhe që të zgjojë botën, tund
bolet-lavjerrës të kohës.*

II.

1. *Dhe ecin, ecin përmbi tokë,
tetë thundra edhe katër kokë.
Dhe kokat janë të rënda.
Dhe thundrat janë të ngrëna.*

Më vjen keq pér Jagon

*Flet e stërflet dikush,
zgavrat e qiellit mbush,
me fjalë tē stérthëna.*

2. *Kjo Botë pjellë zurare,
shkërdhyer, ashtu, vendçë!
Dhe urtësi e marrë,
dhe marëzi e mençme.*

*Qiellin që tē mos bjerë
e mbajën Atlantë-kopukë.
tē pjellë e stërpjellë
nga prindër Titanë-xhuxhë.*

3. *Pérposht! Pérposht! Pérposht!
Në humbëtirë hamendje...
Gjithnjë edhe më poshtë,
kërkojmë një kandil mendje.*

- *Përse kështu, imzot,
kjo është tē bësh kryq:
tē biesh kaqe poshtë
që tē ngrihesh dy gisht...*

4. *Pérposht! Pérposht! Pérposht!
Në terrin e paterrë;
në qorrsokakë tē vetes
zbrit tuneleve sterr!*

*Në errësirë të jetës
një fije drite ndiz,
heu, Kalorës i tretur
nër shtigje tragjedish!*

5. *Më jep një fjalë të vetme,
të thashë:- Një fjalë më jep!
Në hutimin e vjetëve,
huton shek.XX.*

*Oiii! Zeroja e gjorë,
mjeron në errësirë!
Ndën thundër Don Kishoti
jep shpirt zeroja e mirë.*

*Vajton zeroja njeri,
ulërin zeroja shok.
Gërdalla Rosinant
shkelmin e paska trok.*

7. *Shiko zeron djersë,
diç thotë e asgjë s'hotë.
S'ka shpresë më zeroja Shpresë,
dhe unë më shpresë-kot.*

*Punëtori e fshatari,
gozhdë që s'ka kokë:
nga mesi e lart - Rroftë!
nga mesi e poshtë - Poshtë!*

8. *I verbër Rosinanti
çan terrin verbërisht
Shpirtrat e dheut fiken,
sikur një të mos ish.
Frika duartrokitet,
tmerri bërtet fortë:
nga mesi e lart - Rroftë!
nga mesi e poshtë - Poshtë!*

9. *Unë Krisht nuk jam. Mbi supe
e hodha kryqin "Pse?"
Për nder, në trurin tuaj,
është Golgothaja e re.*

*I téri i kryqëzuar
unë ngulur atje,
ku bie "pse?" e vjetër
ku ngrihet "pse?" e re.*

10. *Imzot,jam apo s'jam?
Në jam, po cili jam?
Një emër, vetëm Sanço.
Po ti godit mbi Ço -
e ja ku mbetet San, -
ahere bjer'mbi an, -
dhe ja ku mbetet S!
S!
SS!
SSS! Imzot jam.*

- *Hej, kush kalon atje?*

- *Ssst! Imzot jam.*

*Zuzarë e rrufjanë
qenkan ngritur sonte
të na presin rrugën.*

- *Shpirt zemër kukudhë!*

- *Hej, kush kalon atje?*

- *Ssst! Imzot jam.*

11. *Vetëm zbrazëtirë...
Trokojmë humnerës vetëm.
“Asgjëja” është më mirë
taban i kombit vjetër.*

*Kuptimi i çdo kuptimi,
lavdi e çdo lavdie,
ky trup, ky shpirt, ky tru,
i tërë prej zbrazëtire.*

12. *Je tepër i vërtetë,
për të qenë i vërtetë.
- Imzot, drita e shumtë
verbon syrin e shkretë.*

*Dhe oqeani vetë
e ka bregun e tij.
- Imzot, Prehistori
më je në Histori.*

13. *Je veshë që s'dëgjon,
nuk do të shohë syri.
Kur unë mbaj përbrenda
zemrën epokë guri.*

*Je art i tërë, imzot,
vërteta e gënjeshtërt;
e tashmja artistike
më je përbrenda vdekjes.*

14. - *Hej, kush kalon atje?*
- *Njerëz, të kësaj Bote.*

*Nëpër shkëmbenj tmerri
ku jeton qiklopi.*

- *Po fle, apo është zgjuar?*
- *Kalo, mjerush mjerushi!*
- *Hej, kush po kalon atje?*
- *Kurrikushi...*

15. *Gomari i mençën e i urtë
tund sahatet e Botës.
Një fije drite shpon në trutë
terrin... këndoijnë këndojsit.*

III.

1. *I tëri kryqëzuar
në udhëkryq atje:
ku kalbet "pse?" e vjetër,
ku mbin "pse?" e re.*

*Këmbëçarë në llucë
barktharë në shi, -
40 vjet këpucë
një fjalë: "Mrekulli!"*

2. *Rreth teje tufë moluskë,
rreth teje tufë kopukë;
rreth teje vetëm "gjysëm!",
rreth teje vetëm "nuk!".*

*Kur populli fëmijë,
popujt fëmijë kërkon. -
Me dhëmbë piramidash
prej popujve na ndan.*

3. *Një firmë e vogël Sfinksi
në shkretëtirën shkresë:
dekada trimërish
para saj shurrepsen.*

*Syri i qiellit u mbyll,
Ti... dhe më asgjë.
Humbi Pol i Veriut,
i Jugut s'gjendet më.*

4. *Kalëron Rosinanti
nëpër dritën terr,
pas tij gomari i Sanços
fundbishtit i merr erë.*

5. *- Imzot, më humbe sysh
mes mjegullash e blozrash, -
lundron kjo armaturë
e bërë si prej lodrash.*

*Mbërthyer me një ligj,
kopsitur me një nen, -
lajthitje e Historisë
më rren edhe s'më rren.*

6. *Ky telefon i zi
në cepin e tryezës,
është arkivoli i im
që ecën e po ecën.*

*Në bark të telefonit
një cingërimë teli.-
Lemerri e shpirtrave
më vjen nga përtejferri.*

7. - *Imzot, jam shumë i vdekur,
për të qenë i vdekur;
jam epokë akullnajash
që lëçit mbi vetveten.*

*Jam humbëtirë e bardhë
e zemër gri njëhëresh.
Nga brinjë e Diellit tim
rrjedh ujë e gjak i verdhë.*

8. *Jesui vet mbi supe
e hodhi kryqin "pse?".
Për nder! Në trurin tuaj
është Golgothaja e re.*

9. *Përposht! Përposht! Përposht!
Në humbëtirë hamendje...
Shkojmë para, ecim pas,
marshojmë po në një vend.*

*Ai me dorë të tij
na vërtit kokë e qafë:
- E ardhmja jote është
përjetësisht pas!*

Më vjen keq për Jagon

10. Ç'vjetërsirë, im-shok, gjithçka e vjetër:
burgjité trurit të vjetra,
drita e syrit e vjetër,
përtypja e nofullave e vjetër,
Ç'mbillaçitim ashtu, shok i madh,
tragjedinë tonë?
Ama, ç'rrangallë e vjetër.

11. Uaaa! Si më qenke sot!
Ashtu siç ishe dje...
Dje më ishe i téri,
siç ishte pardje.

Pardje, imzot, më ishe,
siç ishe asaj dite:
monoton i pafund
e gjallë prehistorike.

12. Lavdi e palavdi,
ç'më bën akoma truke?
Kur unë kam rënë kaq poshtë,
përsë më shemb më tutje?

- Mëshirë! i pamëshirtë...
Në këmbë tē tuat rashë. -
Mijra herë vdekur,
mijra shpirtra tē dhash.

13. Krimi atavik
më ndjek si buf në t'errët.

- *Imzot, harrove maskën
në varse prapa derës.*

14. *Pëlhirë e natës ra,
u këput perde e skenës.*

*Jo më nëpër kulise:
tani vet komedia e mjerë e Shqipërisë,
si në pëllëmbë të dorës, lozet në mes të
ditës.*

*Tani dhe vdekja ime
më s'ka se çfarë më bën.*

- *Hej, kush shkon atje?*

- *Kurkushi...*

- *Qiklopi zgjuar ësht'a fle?*

- *Kalo, mjerush-mjerushi!*

15. *Gomari i mençëm dhe i urtë
shkon pas i merr erë tokës.
Dhe që të zgjojë botën, tund
bolet-lavjerrës të kohës.*

*Kur mua edhe vdekja ime
më s'ka se çfarë më bën.-
I vdekur arrij përtej vdekjen
që të ngrihem në këmbë.*

1983

Më vjen keq për Jagon

1983

L E N D A :

1) Më vjen keq për Jagon	3
2) Oh, që paskemi të gjithë.....	4
3) Kur lozim me vetveten.....	5
4) Më vjen përtë qeshur me tragjeditë.....	6
5) Ku të varros?	7
6) Për gjithë dashuritë	8
7) Aspirinat	9
8) Papagajt	10
9) Lindja e dashurisë	12
10) Me arkivolin tim mbi kurriz eci.....	14
11) Nuke di ç'kohë qe.....	16
12) Edhe pa Fatosin	17
13) Timos më lervetëm	18
14) Në kaq pak Tiranë	19
15) Vargje gushti	20
16) Në fund të fundit Troja kishte rënë	21
17) Ubi heroës?	22
18) Oh, që ishim të mirë ne	23

19) Kur ndaheshim ne.....	24
20) Në 40-vjetorin tim	25
21) Vargje spitali	26
22) Jushkonit përk ku?	27
23) D.....	28
24) N'udhëkryq të jetës pres	29
25) Bëjeni përmua	30
26) Ah, liri.....	31
27) X X X	32
28) I ndershëm si vdekja	33
29) Tepër modern unë	34
30) Anës Vjosës	35
31) Duke shkelur mbi gjelbërimin e ditëve	40
32) Më jepni një emër	52
33) Përpara gjernë Humbëtirë	54